

Zef

**REPUBLIKA SHQIPERISE**  
**GJYKATA RRETHIT GJYQESOR ELBASAN**

Nr. 381 Regjistri Themeltar  
Datë 16.04.2015 Regjistrimi

Nr.381 Vendimi  
Datë 18.04.2015

**V E N D I M**  
**PER VENDOSJEN E MASES SE SIGURIMIT PASUROR**

Gjykata rrethit gjyqesor Elbasan e perbere prej

**Gjyqtar Arben Vrioni**

Asistuar prej sekretare Entela Ibershimi, sot me date 18.04.2015, ora 10.00 mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore kerkesen e:

**K e r k u e s** Prokuroria Rrethit Gjyqesor Elbasan perfaqesuar nga prokuror Kreshnik Ajazi

**O b j e k t i** Kerkohet vendosja e mases se sigurimit pasuror, sekuestros preventive mbi pasurine, ne baze te n 274 e vijues K.Pr.Penale

Gjykata pasi celi seancen gjyqesore, degjoi prokurorin, administroi provat

**V E R E N**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimi penal nr.788, viti 2015, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga nen 287 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim Olsi Beheluli.

Nga aktet e këtij procedimi rezulton se, shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan kanë referuar materialet në ngarkim të shtetasit Olsi Beheluli.

Nga të dhënat e policisë gjyqsore rezulton dyshimi se në llogarinë bankare të shtetasit në fjalë janë kryer transaksione të pajustifikuara dhe mbi bazën e burimeve të dyshimita.

Sipas të dhënavë të para, rezulton se në llogarinë bankare të shtetasit Olsi Beheluli dhe familjarëve të tij janë kryer nga ai personalisht dhe familjarë të tij transaksione bankare të copëzuara dhe se prej tij disponohen pasuri të tjera me burime të dyshimta kriminale.

Nga të dhënat hetimore ka rezultuar se shtetasi Olsi Beheluli dyshohet të jetë i përfshirë në fushën e trafikimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike për qëllime

prostitucioni në shtetin anglez. Kështu ka rezultuar se Olsi Beheluli dhe dy bashkëpunëtorët e tij shtetas shqipëtarë Besim Topalli (Rrogosjinë/Kavajë) dhe Azem Proshka (Rrogosjinë/Kavajë), janë arrestuar në Londër pasi ju është gjetur drogë e llojut kokainë dhe heroinë me vlerë mbi 4 milion GBP, të holla cash në vlerë 250.000 GBP dhe dokumenta te falsifikura.

Nga të dhënrat operative dhe ligjore ka rezultuar se familjarët e personit nën hetim dhe konkretisht shtetasi Bardhyl Daut Beheluli rezulton se më dt.01.09.2014 ka depozitar 22.000.00 GBP ne llogarinë e tij në Bankën Kombëtare Tregtare dhe i ka kaluar në depozitë me afat me përshkrim “të ardhura nga emigracioni”.

Gjithashtu nga viti 2013 në emër të shtetasit Bardhyl Daut Beheluli rezulton një automjet BMW tipi 320i me targa AA 477 FO.

Shtetasi Olsi Beheluli rezulton se ka hyrë në dt.15.12.2012 në Republikën e Shqipërisë me një automjet me targë HY04HYF dhe ka dalë nga Republika e Shqiperise më dt.21.01.2013 me linje ajrore British Airëays, që do të thotë se kjo targë i përket kësaj BMW që tashmë është në emër të atit të tij.

Po kështu babai i shtetasit Olsi Beheluli shtetasi Bardhyl ka qarkulluar fonde në sistemin bankar konkretisht ka gjendje në depozitë shumën 20.500 GBP dhe nr.llogarisë së depozitës është 2222AL0220533698297385TIMDEPGBPW pranë Bankës Kombëtare Tregtare, llogari e cila është e përbashkët me gruan e tij Suzana Beheluli.

Sa më sipër gjykata vlerëson se është e nevojshme vendosja e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare pranë Bankës “BKT” në emër të prindërve të personit nën hetim si dhe vendosja e masës së sekuestros preventive mbi automjetin me targë AA 477 FO.

Vendosja e kësaj mase është e nevojshme pasi lënia e lirë e transaksioneve mbi këto llogari bankare dhe pasuri krijon mundësinë e tjetërsimit, ndryshimit dhe fshehjes së këtyre llogarive bankare dhe të shumave të parave në to si dhe krijon mundësinë e kryerjes së zgjatjes dhe rëndimit të pasojave të veprës penale.

#### **PER KETO ARESYE**

Ne baze te n.274 K.Pr.P.

#### **V E N D O S A**

- Pranimin e kerkeses se organit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

- Vendosjen e mases se sigurimit pasuror preventive te sekuestros preventive mbi llogarine bankare nr .2222 Al 022 053 369 8297 385 TIM DEP GBPW pranë Bankës Kombëtare Tregtare ne emer te shtetasve Bardhyl Daut Beheluli dtl.26.06.1963 dhe Suzana Beqir Beheluli dtl 22.02.1967.

268

Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi automjetin me targa AA 477 FO , tip BMW , ne emer te shtetasit Bardhyl Beheluli, prane DRSHTRR Elbasan.

Urdherohet prokurori per zbatimine ketij vendimi.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatene Apelit Durres, brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes se tij.

- U shpall ne Elbasan, sot me date 18/04/2015.

G J Y Q T A R I  
Arben Vrioni

S E K R E T A R E  
Entela Ibershimi

EE

Arben Vrioni

28/04/15

JY

JL